



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 12, datë 06.02.2024

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË TETËMBËDHJETË TË 10 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.8, datë 28.01.2021 “Për miratimin e kontratës model për kalimin e masës së grantit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 sipas projekteve model nga Bashkia Durrës tek përfituesi” dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK  
VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së tetëmbëdhjetë të 10 subjekteve përfituese, të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019,

sipas projektit model, pasqyruar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij, hartuar nga Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria Ekonomike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 07.02.2024**



ANEKSI I. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA MASA E GRANTIT TË RINDËRTIMIT

NR	NJESIA ADMINISTRATIVE	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	STRUKTURA E BANESËS	VLERA E GRANTIT
1	R5	NEZIR	TAFIL	LILA	4	2+1	2,617,558
2	R5	XHEVDET	RAMADAN	DULE	4	2+1	2,617,558
3	R5	MYLAZIM	SELIM	GJINI	4	2+1	2,617,558
4	R6	YLLSON	QANI	PENGU	6	3+1	3,428,958
5	R6	FITNETE	QAMIL	GJUZI	1	1+1	2,236,552
6	RRASHBULL	MUSA	HAMDI	LILA	5	3+1	3,428,958
7	RRASHBULL	ABDYL	IDRIZ	GASHI	4	2+1	2,617,558
8	KATUND I RI	MARK	PREND	VLASHI	3	2+1	2,617,558
9	ISHEM	ZANE	SALI	HALIMI	1	1+1	2,236,552
10	ISHEM	KADRI	BEGTASH	BEGA	5	3+1	3,428,958





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 94/12 prot.

Durrës, më 15.02.2024

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
Durrës**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
Durrës**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.12 datë 06.02.2024 “Për miratimin e listës së tetëmbëdhjetë, të dhjetë subjekteve përfituese, të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i atës 26.11.2019, sipas projektit model.”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

